

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 10.07.2024, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit të gjykatave ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) dhe neni 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi Iniciativën për miratim të mendimit juridik parimor, të paraqitur nga avokati Andreja Radinovski nga Shkupi, nxori këtë:

KONKLuzion

Iniciativa për miratim të mendimit juridik parimor e paraqitur nga avokati Andreja Radinovski nga Shkupi, e evidentuar nën Su-03 Nr.322/2024, NUK MIRATOHET.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 të Ligjit të gjykatave, avokati Andrej Radinovski nga Shkupi, më 07.05.2024 në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzoi iniciativë, e evidentuar nën Su-03 Nr.322/2024, për miratim të mendimit juridik parimor mbi çështjen juridike: A mund ta shfrytëzojnë pushimin vjetor të gjithë gjyqtarët pa përjashtim të Gjykatës së Apelit, duke filluar në afat prej 9 ditëve nga paragrafi (1) i përcaktuar i nenit 72 të Ligjit të gjykatave.

Me këtë iniciativë paraqitësi bashkëngjiti: Parashtresë drejtuar Këshillit gjyqësor të RMV dhe Njoftim mbi parashtresën drejtuar Këshillit gjyqësor të RMV.

Në shtojcë të iniciativës nga paraqitësi nuk është dorëzuar praktikë e ndryshme gjyqësore, përkatësisht nuk janë dorëzuar vendime, nga të cilat do të rezultonte nevoja për miratim të mendimit juridik parimor nga i cili do të rezultonte zbatimi i ndryshëm dhe mos qëndrueshmëria në zbatimin e Ligjit të gjykatave, me iniciativën janë dorëzuar vetëm: Parashtresa drejtuar Këshillit gjyqësor të RMV dhe Njoftimi mbi parashtresën drejtuar Këshillit gjyqësor të RMV.

Për arsyet e sipërcituara Seanca e përgjithshme konstaton se nuk rezulton nevoja për miratim të mendimit juridik parimor.

**Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme
të Republikës së Maqedonisë së Veriut**